



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 135/13
Prishtinë, më 04.12.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Sevdije Lama.

Munguan : Sali Asllanaj, Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli , Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj, Qerkin Berisha, Petrit Popova, Liridon Maksuti .

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014;**
- 3. Miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoj se miratohet rendi i ditës.

5.Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryetarja do ta shqyrtomë pjesën tekstuale nen për nen dhe ku anëtarët e komisionit e shohin të nevojshme për të ndërhyre ndalim. Në komision janë ngrit disa shqetësime edhe gjatë leximit të pare besoj që tash jemi në gjendje t'i konkretizojmë ato dhe t'i rregullojmë nenet e caktuara.

Naser Osmani tek Agjensioni Kosovar i Pronave dhe Agjensioni Kosovar i Privatizimit kemi dy opsione me të njëjtën shkurtes (AKP), këtu është bërë lëshim kur është bërë zyrtarizimi i atyre shkurtesave

Komisioni njëzëri miratoi propozimin që në tërë tekstin e projektiligjit ku përmendet AKP, të shkruhet emri i plotë, Agjensioni Kosovar i Pronave apo Agjensioni Kosovar i Privatizimit, varësisht prej kontekstit të fjalisë.

Kryetarja tek pika 1.8 nganjëherë po kemi probleme sidomos tek agjencionet e pavarura. Tek të ardhurat e dedikuara që janë para publike të cilat janë të përfituara nga burimet e të të ardhurave dhe kërkohet të ndahen sipas ligjit të buxhetit për agjencionin e pavarur.

Qerkin Berisha me ligj të buxhetit nuk munden mu nda ato si të hyra të dedikuara nëse nuk janë të parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe me ligjin e buxhetit nuk mund të krijojmë bazën e mjaftueshme për të hyra të dedikuara, duhet ose me ligjin e Financave Publike aty me qenë si të hyra të dedikuara ose me ligje të veçanta.

Latif Gashi këtu e len të nënkuptohet që duhet të nxirret një ligj i veçant për rregullimin e të hyrave të dedikuara, prandaj është mirë që këtu ose të specifikohet ose për cilin ligj është fjala ose të caktohet një formë tjetër, ngase forma siç është është gabim.

Besim Beqaj unë mendoj se çështja është ngase nuk është vetëm një ligj për Menaxhimin e Financave Publike nuk është gabim nëse mund ta quajmë me ligj, ne mund të themi edhe me ligjet tjera nuk është problem por gjithmonë kur thuhet kërkohet me ligj nënkupton të gjithë legjislacionin që e përcjell një çështje që rregullohet me bazën ligjore.

Kryetarja mendojë që është më mirë të mbetet ashtu siç është në ligj.

Naser Osmani sa i përket nenit 4, paragrafi 5 që ka të bëjë me ndarjet komunale buxhetore, mendoj që duhet të jetë kështu: deri në themelimin e komunës së re ndarjet buxhetore mundë të shpenzohen vetëm nga komunat ekzistuese për qëllime nga të cilat përfitojnë komunat brenda zonave kadastrale të komunave të reja dhe në konsultim me palët relevante. Këtu është dashur të jetë në konsultim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kjo me përfaqësues të popullatës duhet të hiqet se mundë të jetë askush përfaqësues i popullatës pa ju nënshtrua votës.

Besim Beqaj ideja e këtij teksti ka qenë sepse menaxhimi i buxhetit për komunat e reja siç është edhe ajo e zyrës Administrative të veriut ka qenë e përfaqësuar këtu. Por ne besojmë që edhe kompozimi i tekstit i cili u propozu është në harmoni me rregullën buxhetore prandaj mundë ta bëjmë kështu.

Kryetarja të njëjtën gjë siç po e thekson Naseri është edhe në ligjin për kufi administrativ të komunave d.m.th në të njëjtën mënyrë siq po e përcakton kjo rregullohet edhe me Ligjin tjetër, pra është një harmonizim me legjislacionin .

Latif Gashi tek neni 4 paragrafi 5 me shtua, tek fjalia e fundit në vend të zonës kadastrale të jetë komunës së Mitrovicës Veriore ngase po flitet për zonën kadastrale të Mitrovicës Veriore.

Pas propozimeve, Komisioni njëzëri miratoi ndryshimin e paragrafi 5 të nenit 4 si në vijim:

Neni 4, paragrafi 5, në rreshtin e dytë, fjala “komunitetet”, zëvendësohet me fjalën “komunat”. Në rreshtin e tretë dhe të katërt, teksti “dhe në konsultim me palët relevante, përfshirë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe për përfaqësuesit e popullatës së zonave kadastrale”, zëvendësohet

me tekstin ”dhe në konsultim me Ministrinë Administrimit të Pushtetit Lokal”. Poashtu në rreshtin e fundit, fjalët “zonës kadastrale të”, zëvendësohen me fjalët “Komunës së”.

Kryetarja tek neni 9 pika 2 i cili thotë se : të gjitha tarifat e transmetuesit publik të transferuara në fondin e Kosovës nga ana e RTK-së që përbëjnë 5% të tarifave të transmetuesit publik dhe që janë të përcaktuara për përkrahjen e mediave minoritare shumetnike dhe në situata të pafavorshme përmes kësaj i ndanë zyrës së kryeministrit në përputhje me paragrafin 11 të nenit 20 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës. Referenca është bazuar në ligjin e vjetër të RTK-së dhe në ligjin e ri nuk është rregulluar kjo qështje. Ajo që më intereson të dijë është bërë ndajra e mjeteve me buxhet për këtë qëllim.

Latif Gashi le të mbetet zyra ligjore e Ministrisë me shiku edhe ne shiqojm dhe ta tejkalojmë këtë .

Duda Balje theksoi se mjetet financiare për përkrahjen e media minoritare shumetnike, me ligjin e vjetër të RTK-së janë paraparë që shkojnë përmes Zyrës për Komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit. Por me ligjin e ri të RTK-së kjo qështje nuk është rregulluar fare dhe si rezultat këto mjete nuk janë ndarë që nga ajo kohë.

Hykmete Bajrami tek nen 9 te ndarjet buxhetore tjera në fakt i kemi tri qështje të ndryshme që janë në përfshira në një nen, kjo ndoshta është dashur që mos të mbetet në cilësi të paragrafit po këtë nen të veçantë edhe për AKP-në edhe RTK-ën por gjithashtu edhe për fondin zhvillimor të veriut. Ne jemi dëshmitarë të seancës së parë të leximit të draft ligjit për vitin 2014 të buxhetit dhe ajo çka është kërkuar nga shumica e deputetëve dhe ne e kemi kërkuar zëshëm ka qenë që të hyrat buxhetore nga pika 1 dhe 31 të paraqiten në tabel të buxhetit në pjesën e të hyrave të paraqiten si të hyra dhe në pjesën e shpenzimeve të na paraqiten si të dala të cilat mandej kalojnë në llogari të bankës komerciale.

Besim Beqaj ne edhe në vitin e kaluar e kemi paraqitur me shumën zero sepse mjetet të cilat do të shkojnë në fondin e mirëbesimit për komunat e veriut do të jenë mjete të cilat grumbullohen me destinim për atë pjesë, prandaj ne e kemi pas të pamundur të themi se do të mbledhim kaq apo aq sepse do të ishte jokorrekte me thonë sot do të mbledhen. Eshë me rëndësi që është paraqitur si ndarje buxhetor edhe zero dhe ajo do të plotësohet.

Hykmete Bajrami tani nuk e kemi as zero në këtë draft –buxhet.

Besim Beqaj nëse nuk është zero atëherë është gabim dhe do të përfshihet.

Latif Gashi jam dakord me atë që të futet zero dhe duke marrë parasysh që ligji nxirret vetëm për një vit nuk qëndron ajo që do të jetë traditë me qitë çdo herë zero.

Agim Krasniqi kjo është faqe. 38 tabela 3.1

Naser Osmani tek neni 11 pagesat e paradhënies paragrafi 2 këtu ne e kemi dhe deputetet e kuptojnë çka është fjala kur ipet një paradhënie 100 % ne raste specifike që ndodhin brenda FSK-së apo Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë qështje shumë specifike. Kjo duhet të rregullohet më mirë që jo me rekomandimin nga Komisioni për Buxhet dhe Financa se komisioni i rekomandon vetëm parlamentit duhet të rregullohet mirë për raste specifike duhet me shënu që dihet cilat janë qështje specifike.

Besim Beqaj për raste specifike plotësisht pajtohem sepse është qështje e rëndësishme por megjithatë kisha mendu sepse janë dy institucione gardianë të buxhetit një është Ministria e Financave dhe

Komisioni për Buxhet dhe Financa. Pas konsultimit mundem me than pas konsultimit me komisionin paraprak, pra gjithsesi duhet të jetë edhe komisioni sepse është zë i parlamentit tek e fundit çdo zë në buxhet duhet të bëhet përmes parlamentit dhe së paku duhet me qenë Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryetarja ministër duhet pak me rregullu këtë sepse ne gjatë këtij viti kemi pas një kërkesë të llojit të till dhe me u leju paradhënie ka pas kurfar dëshmie vetëm me emër të projektit. Në bazë si është shkruar kpëtu ne pranojm propozimin nga qeveria dhe ne e japim rekomandimin pro ose kundër dhe e dërgojmë mendimin tone qeverisë, e cila e radhitë në një mbledhje tjetër për me e aprovue më tutje.

Hykmete Bajrami theksoj se nuk kemi nevojë me e ndërru fjalën rekomandim me fjalën konsultim, sepse fjala konsultim është më e but ë e nëse e lëmë konsultim, qeveria mund të na sjell propozimin dhe ne edhe nëse e kundërshtojmë, në bazë të kësaj si është shkruar, qeveria prap mund të aprovoj.

Latif Gashi nëse ne themi rekomandimi i komisionit ajo kuptohet se çdo rekomandim i dërgohet Kryesisë së Kuvendit e cila pastaj e procedon në seanceë plenare. Ne si komision nuk bëjmë rekomandime për qeveri dhe kjo e komplikon procedure.

Naser Osmani propozoj që fjala konsultimit të zëvendësohet me fjalën pëlqimit.

Në bazë të propozimeve, Komisioni njëzëri miratoi ndryshimet në paragrafin 2 të nenit 11 si në vijim:

Neni 11, në paragrafin 2, në rreshtin e parë fshihen fjalët “Në raste të veçanta”. Poashtu në rreshtin e parë, pas fjalës “paradhënies”, shtohen fjalët “për rastet specifike”. Gjithashtu në rreshtin e katërt, fjalët “rekomandimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të Kuvendit”, zëvendësohen me fjalët “pëlqimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës”.

Naser Osmani sa i përket paragrafit 3 të neni 11 praktika ka treguar se dijmë ti keqpërdorim shfrytëzimin e mjeteve buxhetore deri në fund të vitit, prandja unë kam kërkuar që ky paragraf të ashpërsohet. Duhet gjetur një formul të përshtatshëm që me mbajt nën kontroll buxhetin që të mos hargjohet në dy muajt e fundit e sidomos prej kryetarëve të komunave që i shfrytëzojnë mjetet jashtë procedurave.

Besim Beqaj unë mendojë se është mjaftë e ashpërsuar, por mundet të metalizohet edhe më shumë. Unë kam marrë një vendim në bazë të autorizimeve që më jep ligj, që në të muajet e fundit, asnjë projekt që nuk janë zotuar mjetet të mos mund të nisin marrëdhëniet e reja kontraktuale nga organizata buxhetore. Mjetet që janë flokuar dhe të gjitha kontratat përdoruese janë proces të vazhdueshëm të implementimit.

Agim Krasniqi theksoi se është mirë të specifikohet se paradhënia jepet për mjetete të cilat janë pjesë e tabelave të viti vijues.

Kryetarja sqaroi se është e shkruar se për muajin nëntor lejohen mjetet e paradhënies 10% e vlerës së kontratës dhe për muajin dhjetor 5% e vlerës sp kontratë për projektet që janë pjesë e vitit vijues.

Hykmete Bajrami propozimi im do të ishte për projektet qe janë në implelementim e sipër per muajin nentor do të lejohet pagesa e paradhënies në maksimumi deri në 10% dhe në muajin dhjetor maksimumi deri në 5% .

Latif Gashi mendojë se duhet të çeket se ndalohen pagesat e paradhënies për projektet e pa planifikuara, pjesa tjetër të mbetet.

Kryetarja njoftoi se në paragrafin 4 të nenit 12 kemi një amendament të propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni dhe e citon tekstin e amendamentit.

Latif Gashi mendojë se fjalia e fundit “ ndarjet e mjeteve mund të shpenzohen pas vlerësimit fiskal” duhet të mbetet, sepse nuk guxojmë me nda mjete pa e diturs koston e ligjit..

Hykmete Bajrami unë mendojë se duhet të ulemi së bashku me përfaqësuesit e ministrisë së financave dhe të shqyrtojmë implikimet financiare të amendamentit të deputetit Hyseni, sepse nga përvoja më herët është rrezik që ky amendament të kalojë në seancën sepse është shumë i ndishëm. Unë mendojë se duhet të ftuar edhe deputetin Hyseni që të diskutojmë dhe ti paraqesim argumentet për implikimet buxhetore si dhe mendimin e ministrisë së financave.

Besim Beqaj sqaroi se askush nuk ka kërkuar me ba limitime por ne po duam ty hyjmë në një proces të kompensimeve vetëm atëherë kur të kemi komplet dhe të mbyllur listat. Nuk mund ta lëmë listën të hapur që të hyjmë me baza vjetore, sepse kjo shkakton implikime buxhetore me hyrjen e njerëzve të rinj. Ideja është që procesi i vlerësimit dhe lista e përfituesve të jetë finale dhe të fillojë ndarja e mjeteve financiare konform ndarjeve buxhetore. Për këtë jemi dakorduar edhe me FMN-në.

Latif Gashi theksoi se duhet patur kujdes se nëse amendamentin shkon në seancë, mund të aprovohet, prandaj është mirës si komision së bashku me ministrin e financave të thërrasim deputetin dhe të argumentojmë se është gabim teksti si është propozuar. Realisht është mirë unanimisht si komision me vendos për këtë qështje se është interes i përgjithshëm.

Naser Osmani sa i përket nenit 12, paragrafi 7 është një formulim politik dhe unë e di se në momentin e caktuar ka me u marrë një vendim dhjetë ditë pa u shpallur zgjedhjet dhe ka me u rritur rrogat arsimtarëve dhe si të tillë nuk e përkrahu. Kjo ka mundur të shpërndahet për pagat e shërbyesve civil dhe të mbetet në këtë formë që për qëllime politike të bëhet shpërndarja e mjeteve.

Besim Beqaj ne në fondin kontingjent kemi pagat dhe mëditjet dhe rritja e tyre duhet të jetë një reflektim i një vendimi të qeverisë, prandaj po të hiqet duhet të kemi specifikim të qartë në buxhet se cilat janë ato rritje. Unë besojë se kjo është në harmoni me rregullat buxhetore dhe kërkojmë të mbetet siç është propozuar.

Hykmete Bajrami sa i përket qështjes së shpenzimeve kapitale shuma prej 7.5 milion eurove rekomandoj të reflektohet në tabelat e buxhetit dhe të mos mbetet vetëm në tabelën 3.1. Sa i përket paragrafit 7 të nenit 12, jamë kundër siç është propozuar mënyra e rritjes së pagave, ne mendojmë se pagat duhet rritur në mënyrë proporcionale dhe si i tillë fondi kontingjent prej 48 milion euro ka qenë e mundur të ndahet, varësisht prej numrit të punëtorëve për të gjitha institucionet dhe administratën publike.

Agim Krasniqi sqaron se te pika, paragrafi 12 është se emërtimi i shpenzimeve të paparashikuara nënkupton rezervat e qeverisë. Më heret këto rezerva i kemi vendos në kategorinë e rezervave dhe i kemi ndarë në dy kategori: shpenzime kapitale dhe për shpenzime operative dhe është e njëjta gjë vetëm paraqitja ndryshe. Sa i përket qështjes së fondit kontingjent, i ka dy komponentet: komponenten që lidhet me reformën në administratën publike dhe komponenten që është rritje e pagave. Duhet të kryhet procesi i reformave në administratën publike dhe miratimi i ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, siç është ligji për

funksionarët e lartë publik, rregullorja për shtesa për shtyesit civil, dhe mbi bazën e saj caktohet një strukturës e re për gjithë pagat e shërbyesëve civil dhe kjo është teknikisht që duhet të rregullohet.

Naser Osmani sa i përket paragrafit 2 të nenit 13 që flet për mundësin që qeveria sipas propozimit të ministrisë së financave të bëjë shkrutimin e 5% e shumës kumulative të buxhetit dhe të shpërndaj nëpër organizata buxhetore. Unë konsideroj se çdo ndërhyrje në ligj kërkohet një aprovim nga Kuvendi dhe në një farë mënyre kjo është një rishikim i buxhetit. Nuk jemi kundër të bëhen këto risisteme, por vetëm të respektohen procedurat ligjore.

Besim Beqaj të gjithë jemi të interesuar që të rrisim sa më shumë efektivitetin e planifikimit, por meqë është fjala për tre muajt e fundit është shumë vonë për rishikim buxhetor. Qëllim është që shpenzimet me arritur efektin ekonomik dhe menaxhimin më të mirë të parasë publike.

Naser Osmani kam frikën se kjo bjen në kundërshtim me paragrafin 1 që kryetarët e komunave të kërkojnë për projekte të rej që nuk kanë kaluar në procedura të aprovimit në asamblë dhe unë konsideroj se kjo është ndërhyrje në ligj dhe është mirë me shkue në procedurë të rregullt.

Agim Krasniqi sqaron zakonisht gjatë rishikimit ka ndodhur janë aprovuar edhe projekte të reja dhe këto projekte kanë një vlerësim dhe realisht ky vlerësim në kushtet e tregut mundet gjithëherë me lëvizje dhe ky paragraf është futur që me iu dhanë organizatave buxhetore mundësinë me ba lëvizjen e mjeteve prej një projekti në tjetrin. Qështja e dytë ka të bëjë me donatorët, që gjatë procesit të ekzekutimit të buxhetit por shprehin gatishmërinë për të financuar projektet apo bashkëfinancime dhe kjo është për t'iu ofruar mundësi ministrive për të bërë këto rregullime.

Naser Osmani është rasti i RTK-së që i janë dhënë 1 milion euro që na keni krijuar telashe dhe krejt prej këtyre mjeteve i keni dhënë për projekte të reja.

Besim Beqaj sa i përket RTK-së unë mendoj se nuk është sjellur një situatë e keqe. Lëshimi i kanalit të dytë ka ndikuar që ka ardhur një kërkesë nga RTK dhe e kemi bërë konform mundësive ligjore që kemi. Nëse ne e heqim këtë, kemi me i lënë organizatat me i shpene mjetet e veta me apo pa arsye dhe mos të vijmë në një situatë të tillë që nuk realizohen planifikimet e parapara.

Naser Osmani atëherë një propozim mund të jetë që transferi të mund të bëhet vetëm brenda organizatë buxhetore dhe jo ndërmjet organizatave.

Hykmete Bajrami ne jemi me i vu në disiplinë organizatat buxhetore, por unë gjithashtu mendoj se ne duhet me ditë se çka po quajm shpenzim. Duhet të qartësohen situatat kur bëhen këto shpenzime dhe jo si u potencua më herët. Ne nuk jemi kundër shkrutimeve por jemi kundër alokimit me çfarëdo kritere që këto mjete por alokohen. Rialokimi i mjeteve duhet të kalojë përmes Komisionit për Buxhet dhe Financa ose komplet Kuvendit të Kosovës.

Besim Beqaj sqaron se nuk mund të thuhet shkurtim për një organizatë buxhetore nëse ajo nuk ka mundur me i realizue të gjitha procedurat për të përfundue një projekt. Shkurtim është atëherë kur projekti është në vijim e sipër dhe merren mjetet dhe mbetet pa u përmbyll projekti.

Latif Gashi neni 13 paragrafi 2 është mirë të jetë kështu sepse është edhe në harmoni me nentet dhe paragrafët tjerë. Të gjitha organizatat buxhetore e kanë këtë mundësi, fjala është për 5% dhe jo për ndonjë

shumë të madhe. Por edhe nëse dojmë me ba ndryshime për nivelin qendro, të bëjmë ndryshime edhe për pushtetet lokale që e kanë këtë mundësi, ua lejon ligji dhe i kisha lut krjt anëtarët e komisionit të përkrahin.

Naser Osmani nuk është fjala për 5% e një projektit, por për 5% e totalit të buxhetit dhe kjo lënë hapësirë që një organizate buxhetore ti shkurohet buxheti për 50%.

Kryetarja pas komenteve dhe sqarimeve, ne vërejtëm se ka shumë anë pozitive të kësaj siç është propozuar lidhur me menaxhimin e buxhetit ashtu siç sqaruan ministri dhe drejtori i buxhetit. Më pas kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se në mbledhje është pranishëm deputeti Hydajet Hyseni, i cili iu përgjigj ftesës tonë më urgjente, për të arsyetuar amendamentin. E njoftojë deputetin Hyseni, se amendamenti u diskutua më herët dhe nga diskutimet e deputetëve dhe arsyetimet e qeverisë është që të mbetet teksti i nenit 12.4 siç është propozuar nga qeveria.

Hydajet Hyseni theksoi se qështja është zvarritur gjatë dhe koha po kalon dhe do të duhej të ishte rregulluar tashmë. Me rastin e miratimit të ligjit për ish të burgosurit të gjithë kanë qenë për. Nga ana qeverisë dhe ministrisë përkatëse kanë bërë një hapë të cilin duhet ta lavdëroj dhe përgëzoj. Propozimi i qeverisë duhet korrigjuar në disa aspekte, sepse formulimi që është bërë në pjesën e parë mund të ngatërrojë gjithë procesin. Propozimi i parë është që të thuhet ndarjet kontingjente vjetore, pasi që edhe kështu kemi biseduar me ministrin. Vërjetja e dytë është që në vend të fjalës “financimit” të thuhet kompensimit dhe në vend të fjalës “të përdjekurit politik” të shkruhet “të burgosurit politik” sepse ligji kështu e trajton.

Besim Beqaj deputet Hyseni ne kemi pasur disa takime për këtë qështje dhe mendoj se në projektligj janë adresuar në mënyrë shumë të veçantë dhe specifike qështja e kompensimit të të dënuarve politik. Propozimet në pjesën e parë mund, që të thuhet ndarjet kontingjente vjetore, në vend të fjalës financim të përdoret shprehja kompensim dhe fjala të përndjekurit politik të zëvendësohet me të dënuarit politik, për ne si ministri janë të pranueshme. Ne nuk mund të referohemi në ligje tjera, sepse ky është ligj i veçant për ndarjet buxhetore. Unë mendoj që pjesa tjetër duhet të mbetet siç është propozuar nga qeveria sepse edhe në këtë formë është harmonizuar me FMN dhe ndarjet mund të shpenzohen pas kompletimit fiskal dhe përfshin listën përfundimtare verifikuese.

Hydajet Hyseni sa i përket asaj që mos të referohemi në ligje tjera, nuk ka rrezik të ndërlikohet sepse janë ligje të veçanta dhe jam i bindur se zbatimimi i njërit ligj e ndihmon tjetrin por jo kondicionimi. Është fjala për 9 mijë aplikacione të shikohen veq e veq për shqyrtim përfundimtar, është bërë një vlerësim preliminar dhe një përlllogaritje dhe jemi dakorduar.

Besim Beqaj askush nuk ka interes të bllokoj asgjë. Por unë nuk mund të mbroj në raport me FMN që të hyjmë në një proces të pagesës për një kontribut që nuk dihet ku e ka fundin. Përfitues të ri nuk ka dhe do të duhej të kemi numrin e saktë. Prej 9 mijë aplikacione keni ardhur në 4 mijë dhe mbi atë numër kemi bërë përlllogaritjen e kostos financiare.

Latif Gaashi e përgëzoj punën dhe përkushtimin tuaj z. Hyseni dhe sa i përket amendamentit tuaj tu kisha lutur për mirëkuptimin. Unë i mbështes vërejtjet për pjesën e parë të amendamentit. Nuk ka nevojë me thanë viteve, pasi që ligji i buxhetit është një vjeçar. Ju si komision vlerësues nuke keni kryer punën për me nxjerr një numër të saktë 100% të përfituesve dhe definitivisht ka me qindra që presin statusin e të përndjekurit politik dhe puna e komisionit është në përfundim e sipër dhe mos të komplikojmë shumë këtë.

Besim Beqaj komisioni vlerësues ka është i obliguar të sjell listën përfundimtare mbi të cilën bëhet planifikim dhe plotësohet formulari që është standard për obligimin financiar për pesë vite dhe ne nuk e kemi listën finale.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri miratoi ndryshimin në paragrafin 4 të nenit 12 si në vijim:

Neni 12, në paragrafin 4, në rreshtin e parë, pas fjalës kontingjente, shtohet fjala “vjetore”. Në rreshtin e parë, fjala “Financim”, zëvendësohet me fjalën “kompensim”. Si dhe në rreshtin e dytë, fshihen fjalët “dhe përndjekurve”

Amendamenti i deputetit Hydajet Hyseni, nuk përkrahet njëzëri nga Komisioni për Buxhet dhe Financa

2. Miratimi i Raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

Latif Gashi si grup punues kemi realizuar të gjitha aktivitetet e parapara me planin e veprimit dhe konsiderojë se kemi bërë një punë të mirë dhe kemi hartuar raportin me rekomandime që konsiderojë se janë adresuar të gjeturat dhe sfidat nga aktivitetet gjatë monitorimit.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet Raporti me rekomandime i Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Raporti me rekomandime procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi: 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona